

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER PUBLIK

Nr. 2082 rep.

Nr. 769 kol.



KONTRATE SHITBLERJE

Sot me daten 01.07.2004 para meje noterit Thoma BICJA u paraqiten personalisht palet:

SHITËSI : Aleksandros BALAPANIDHIS , i datëlindjes 1974 , lindur dhe banues në Ptolemaiddhë, Kozan të Greqisë , madhor me zotësi juridike për të vepruar,

BLERËSI : Enjti PAZAJ , i datëlindjes 1954 , lindur në Vlorë dhe banues në Korçë , madhor me zotësi juridike për të vepruar .

Palet kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje me permbajtje:

Si shitësi Aleksandros BALAPANIDHIS dhe Blerësi Enjti PAZAJ, janë Ortakë themelues të Shoqërisë " ESSEL " SHPK Korçë , e regjistruar kjo në Rregjistrin tregëtar me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 29.207 datë 03.03.2003 , me kapital themeltar 100.000 lek në pronësi në kushtet e kontratës datë 20.02.2003 të lidhur midis tyre ku janë të barabartë me 50 % vetëm për shpërndarjen e fitimit nga cikli i prodhimit që realizohet nga aktiviteti i shoqërisë , me objekt Veprimtarie " - Prodhimi dhe tregëtimi i bojgrave , llakut , plastikove, stukove, etj. dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit; - Tregëti të artikujve të ndryshëm të ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakicë; - Tregëti i karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apodhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte " .


Nga ana e shitësit Aleksandros BALAPANIDHIS , është vendosur lejimi i transferimit nepermjet shitjes te pjesës kapitalit themeltar si më sipër në masën 50 % ose 1 / 2 e këtij kapitali, ose me vlerë 50.000 lek në favor të blerësit , ortakut tjetër zotit Enjti PAZAJ.


Në këtë mënyrë nga blerja e 50 % e pjesës së kapitalit themeltar të nënshkruar , në shoqëri ngelet vetëm ortaku blerës Enjti PAZAJ, dhe nga ky moment ai zoteron si pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë si dhe në të gjithë kontributet në shoqëri, 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar dhe ngelet ortak i vetëm i themelimit të shoqërisë " ESSEL " SHPK Korçë .

Nëpërmjet kësaj kontrate shitblerje, kryhet tjetërsimi i kapitalit themeltar të nënshkruar për shoqërinë " ESSEL " SHPK Korçë , nga ortaku shitës Aleksandros BALAPANIDHIS tek ortaku blerës Enjti PAZAJ. Cmimi i shitjes është i njëjtë me vlerën e kapitalit themeltar që tjetërsohet dhe është paguar pashtë kësaj zyre.


Përsa më sipër, përmbajtja e kesaj kontrate lexohet prej sejcilit pjesëmarrës, të cilët e gjejnë te perpiluar sipas vullnetit të tyre dhe e nënshkruajnë.

ORTAKU SHITES
Aleksandros BALAPANIDHIS

 N813793



ORTAKU BLERES
Enjti PAZAJ



NOTERI
Thoma BICJA

